



# **BROSHURË RRJETI I SHËRBIMEVE EURAXESS ALBANIA**

## TRAJNIMI DHE WORKSHOP-I “PROMOVIMI I RRJETIT EURAXESS NË SHQIPËRI”



Tiranë 2015

Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit në rolin e Institucionit Drejtues të Rrjetit EURAXESS organizoi në datën 7 Maj 2015 aktivitetin “Promovimi i Rrjetit EURAXESS në Shqipëri”.

Ky aktivitet u organizua me pjesëmarrjen e më shumë se 90 përfaqësuesish nga institucione të ndryshme kërkimore shkencore dhe pikave të kontaktit EURAXESS si dhe me

pjesëmarrjen e ekspertëve të huaj që ndanë me këtë komunitet eksperiencën e tyre në rrjetin EURAXESS, Dimitrios Sanopoulos – CERTH, EURAXESS Greece, Ana Grdovic – AMEUP EURAXESS Croatia, Manda Japuncic – AMEUP EURAXESS, Croatia.

Qëllimi i aktivitetit ishte krijimi i komunikimit fillestar me pikat e kontaktit, prezantimi i strukturës së rrjetit EURAXESS, parashtrimi i politikave dhe iniciativave të BE-së për lëvizjen e punonjësve shkencorë si dhe prezantimi i studiuesve shqiptarë me Portalin EURAXESS në Shqipëri [www.euraxess.al](http://www.euraxess.al) produktet dhe mjetet informative dhe se si mund të marrin informacionin e nevojshëm në lidhje me lëvizshmërinë e tyre.



Tiranë 2015



Tiranë 2015

Numër 2, Qershor 2015

[www.euraxess.al](http://www.euraxess.al)



## **KARTA EUROPIANE PËR KËRKUESIT SHKENCORË DHE KODI I SJELLJES PËR REKRUTIMIN E KËRKUESVE SHKENCORË**

**Karta Europiane për Kërkuesit Shkencorë** është tërësia e parimeve të përgjithshme dhe kërkesave të cilat specifikojnë rolet, përgjegjësitë dhe të drejtat e kërkuesve shkencorë si edhe të punonjësve dhe/ose të financuesve të tyre.

Qëllimi i Kartës është të garantojë se natyra e marrëdhënies ndërmjet kërkuesve dhe punëdhënësve apo financuesve të tyre është e favorshme për një punë të suksesshme në lindjen, transferimin, përdorimin e përbashkët dhe përhapjen e njohurive dhe të zhvillimit teknologjik, si edhe për zhvillimin e karrierës së kërkuesve. Karta njeh gjithashtu vlerën e të gjitha formave të lëvizshmërisë si një mjet për rritjen e zhvillimit profesional të kërkuesve shkencorë.

Në këtë kuptim, Karta përbën një kuadër për kërkuesit, punëdhënësit dhe financuesit, i cili i fton ata të veprojnë me përgjegjshmëri dhe si profesionistë brenda mjedisit të tyre të punës, dhe që ta njohin njëri tjetrin si të tillë. Karta i'u adresohet të gjithë kërkuesve në Bashkimin Europian, në të gjitha fazat e karrierës së tyre dhe mbulon të gjitha fushat e kërkimit në sektorët publikë dhe privatë, pavarësisht nga natyra e emërimit apo punësimit, statusi ligjor i punëdhënësit të tyre apo lloji i organizatës apo institucionit në të cilin kryhet puna. Ajo merr parasysh rolet e shumfishta të kërkuesve, të cilët emërohen jo vetëm për të kryer kërkimin dhe/ose për të kryer zhvillimin e veprimtarive kërkuese por që janë gjithashtu të përfshirë në mbikëqyrjen, udhëheqjen, drejtimin apo në kryerjen e detyrave administrative.

Karta bazohet në supozimin se kërkuesit shkencorë ashtu edhe punëdhënësit dhe/ose financuesit e kërkuesve kanë detyrimin parësor që të garantojnë zbatimin e legjislacionit përkatës kombëtar ose rajonal.

Duke qenë se kërkuesit gëzojnë një status dhe të drejta të cilat janë në disa këndvështrime, më të favorshme se ato të parashikuara në këtë Kartë, kushtet e kësaj të fundit, nuk duhet të përdoren për të zvogëluar statusin dhe të drejtat e përfituara tashmë. Kërkuesit shkencorë, punëdhënësit dhe financuesit të cilët aderojnë tek kjo Kartë do të respektojnë gjithashtu të drejtat themelore si edhe parimet që njihen prej Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian.

**Kodi i Sjelljes për Rekrutimin e Kërkuesve** konsiston në një sërë parimesh dhe kërkesash të përgjithshme që duhet të ndiqen nga punëdhënësit dhe/ose financuesit gjatë emërimit ose rekrutimit të kërkuesve shkencorë. Këto parime dhe kërkesa duhet të respektojnë vlera të tilla si transparenca e procesit të rekrutimit si edhe trajtimi i barabartë i

të gjithë aplikuesve, duke mbajtur sidomos parasysh zhvillimin e një tregu të qëndrueshëm europian të punës, dhe të jenë plotësuese ndaj atyre që janë parashtruar në Kartën Europiane për kërkuesit shkencorë.

Institucionet dhe punëdhënësit që veprojnë në përputhje me Kodin e Sjelljes do të demonstrojnë qartazi angazhimin e tyre për të vepruar në mënyrë të përgjegjshme dhe të respektuar dhe për t'ju garantuar kërkuesve kushte bazë të ndershme, me synimin e qartë për të kontribuar për përparimin e Hapësirës Europiane për Kërkimin.

Institucionet shqiptare që kanë shprehur mbështetjen e tyre të qartë për “Kartën Europiane për Kërkuesit Shkencorë dhe Kodin e Sjelljes për Rekrutimin e Kërkuesve Shkencorë” janë:

1. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit
2. Universiteti i Tiranës
3. Universiteti Bujqësor i Tiranës
4. Universiteti i Gjirokastrës “Eqerem Cabej”
5. Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit
6. Shoqata B.A.ZH NGO
7. Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit Barleti
8. Universiteti Epoka
9. Instituti i Shëndetit Publik
10. Universiteti Polis
11. Akademia e Shkencave të Shqipërisë
12. Fondacioni “Partneritet për Zhvillim”
13. Universiteti European i Tiranës
14. Universiteti Aldent
15. Universiteti Wisdom

Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit do të vazhdojë fushatën e ndërgjegjësimit mbi parimet dhe principet që mbart Karta dhe Kodi.

## EURAXESS ROADSHOW 2015



**Autobusi Blu**

Për të dytin vit rradhazi Komisioni European në kuadër të programit EURAXESS – Research in motion do të organizojë EURAXESS ROADSHOW BUS.

Dy autobusë të nisur nga Komisioni European, një blu dhe një i verdhë do të udhëtojnë rreth Europës me qëllim informimin e kërkuesve shkencorë rreth mundësive për të zhvilluar karrierën e tyre.

Gjate këtij turi të dy autobusët do të ndalojnë në 33 qytete në 16 vende të Europës dhe do të promovojnë shërbimet e Programit EURAXESS, portalin dhe qendrat EURAXESS dhe fondet për financim dhe bursa studimi në Europë.

Iniciativa EURAXESS ofron konsulencë në një gamë të gjerë çështjesh, duke përfshirë shkrimin e një CV, marrjen e një vize pune, të drejtat në punë dhe bashkëpunime ndërkombëtare.



**Luxenburg, 2014**



**Foto për CV, Vienë 2014**

Në vendqëndrimin e autobusit do të keni mundësi që të merrni informacion dhe konsultoheni në dy tenda të pajisura me kompjuter dhe iPad të asistuar nga personat përgjegjës rreth tre shtyllave të EURAXESS, punë, shërbime dhe të drejtat (jobs, services, rights). Në mjediset e autobusit do të keni mundësi të bëni foto profesionale për CV tuaj.

Në Shqipëri autobusi do të ndalojë në dy qytete, në Shkodër më datë 15 Tetor 2015, pranë Universiteti të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” dhe në Tiranë më datë 16 Tetor 2015 pranë Universiteti Politeknik të Tiranës.

## KONFERENCA “EURAXESS”



**Kretë 2015**

Në kuadër të Programit EURAXESS, Komisioni European në bashkëpunim me Rrjetin EURAXESS Greqi dhe Universitetin e Kretës, organizoi më datat 27 deri më 29 Prill 2015 në Kretë, Greqi Konferencën “EURAXESS”.

Kjo konferencë organizohet një herë në dy vjet dhe mbledh sëbashku mbi 250 përfaqësues nga 40 vendet anëtare të Programit EURAXESS. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit në rolin e Organizatës Drejtuese të këtij rrjeti në Shqipëri si dhe në rolin e Qendrës së Shërbimeve Euraxess, u përfaqësua nga 4 përfaqësues. Qëllimi i kësaj konference është mbajtja e kontakteve dhe krijimi i kontakteve të reja me të gjitha vendet anëtare në EURAXESS si dhe informimi në vazhdimësi për ndryshimet dhe vendimet e Bashkimit European për këtë program.

Gjatë kësaj konference u realizuan një sërë aktivitetimesh dhe prezantimesh mbi pozicionin e Programit EURAXESS në Zonën Europiane të Kërkimit, ERA (European Research Area).

Gjithashtu u organizuan dhe 6 Workshop-e paralele me tematikat e mëposhtme:

WS1: Communication, promotion and social media;

WS2: New service development: institutional support in terms of current and new services offered;

WS3: Build your own Dual Career and Integration Services Strategy ! A collaborative learning exercise;

WS4: Career development services: Whats in it for EURAXESS?;

WS5: The international dimension of EURAXESS;

WP6: Intercultural Workshop: Towards a better understanding of Asian Culture;



**Kretë 2015**

Rezultati kryesor i këtij aktiviteti ishte njohja me politikat e reja të Bashkimit European në lidhje me Zonën Europiane të Kërkimit, (European Research Area) dhe veçanërisht me Programin EURAXESS.



## KONTAKTE

### ORGANIZATA DREJTUESE

#### AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr.3, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 409

E-mail: [info@akti.gov.al](mailto:info@akti.gov.al)

Web: [www.akti.gov.al](http://www.akti.gov.al)

### Qendra e Shërbimeve EURAXESS

#### AGJENCIA E KËRKIMIT, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Adresa: Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr.3, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 409

E-mail: [info@akti.gov.al](mailto:info@akti.gov.al)

Web: [www.euraxess.al](http://www.euraxess.al)

### LIDHJE TË NEVOJSHME:

Portali Europian EURAXESS: [www.euraxess.eu](http://www.euraxess.eu)

Portali EURAXESS Albania: [www.euraxess.al](http://www.euraxess.al)

Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit: [www.akti.gov.al](http://www.akti.gov.al)

Ministria e Arsimit dhe Sporteve: [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)





**Boti i dytë u realizua nga:**  
**Rajna Spaho**  
**Nelda Kote**

**Redaktoi:**  
**Lidjana Shahinaj**